



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E STUDIMEVE**

Nr. 1658 Prot.

Tiranë, me 22. 08. 2002

LËNDA: Për vlerësimin e punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

**PROKURORIVE PRANË
GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË**

GJITHË DREJTORIVE

KËTU

Me synim, vlerësimin e punës dhe të aftësive profesionale të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve;

Mbështetur, në nenin 42 të ligjit Nr. 8737 datë 12, 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin Nr. 8677 datë 2. 11. 2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore";

Do të kryhet, vlerësimi paraprak i rezultateve të punës dhe i aftësive profesionale, të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, bazuar në treguesit me sintetik të volumit të punës, cilësisë, shpejtësisë dhe botimit të punimeve juridike, që do të prezantohen në formularët bashkëlidhur.

Treguesit e prezantuar në formularët përkatës, **do ti nënshtrohen verifikimeve,** që do të kryhen nga Drejtoria e Përsoneelit dhe Inspektimit, gjatë inspektimeve për vlerësimin përfundimtar të

aftësive profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Formularët "**Treguesit kryesorë të ndjekjes penale nga Prokurori...**" dhe "**Treguesit e punës të oficerit të Policisë Gjyqësore**", do të plotësohen me të dhënat e treguesve: të volumit të punës, shpejtësisë dhe cilësisë, në ndjekjen penale në hetimet paraprake dhe në ngritjen e përfaqësimit e akuzës në gjyq, si dhe në ekzekutimin e vendimeve penale, për periudhën 1 janar 2001 -30 shtator 2002, duke pasqyruar saktë e qartë secilin tregues, sipas periudhave.

Formularët do të plotësohen për të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe/ose shërbimeve bazuar në:

- regjistrin e njoftimit të veprave penale;
- fashikujt e mosfillimit të procedimeve dhe pushimit të çështjeve në fazën e hetimeve paraprake;
- fashikujt e prokurorit, konkluzionet përfundimtare, vendimet gjyqësore dhe ankimet/apelimet, për procedimet penale të dërguara në gjyq dhe të gjykuara;
- fashikujt e ekzekutimit të vendimeve penale, për urdhërimet e vënies në ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- analizat periodike, statistikat dhe evidencat e treguesve të punës, të mbajtura nga drejtuesi i prokurorisë, si dhe nga secili prokuror dhe oficer i policisë gjyqësore, etj.

Këto formularë **do të plotësohen dhe nënshkruhen nga drejtuesi i prokurorisë**, i ndihmuar nga prokurori që mban regjistrin e procedimeve dhe **do ti bëhen të njohura**, nëse ka observacione apo plotësime, **secilit prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore, të cilët, gjithashtu, duhet të nënshkruajnë formularin përkatës.**

Për realizimin e këtij vlerësimi paraprak të aftësive profesionale, **Drejtuesit e Prokurorive pranë Gjykatave të rrethit gjyqësor, duhet:**

- **që brenda datës 20. 10. 2002**, të sjellin në Drejtorinë e Personelit dhe Inspektimit të kësaj zyre, **formularët e plotësuar qartë, saktë dhe me përgjegjësi**, për të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore që janë në marrëdhënie pune.
- sqarime të veçanta mund të bëhen në relacionin që shoqërojë formularët përkatës.

Për paqartësi që mund të keni në plotësimin e ndonjë treguesi, të kërkojen sqarime në Drejtorinë e Studimeve dhe në Drejtorinë e Personelit e Inspektimit të kësaj zyrë.

Me këtë material të njihen të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve pranë tyre.

Drejtuesit e Prokurorive pranë Gjykatave të rrethit gjyqësor, të marrin masat e duhura organizative,

- **për plotësimin dhe dërgimin,** Drejtorisë së Personelit dhe Inspektimit, të formularëve, brenda afatit të përcaktuar.

Konrollojnë zbatimin, **Drejtorët e drejtorive** të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

Bashkëlidhur, nga një kopje të dy formularëve: "Treguesit kryesorë të ndjekjes penale nga Prokurori..."dhe "Treguesit e punës të oficerit të Policisë Gjyqësore..".

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU



Treguesit			Periudha Raportuese			
			Viti 2001	9 Mujori 2002		
Ndjekja penale ne hetime paraprake	Mosfillime	1 Gjithsej - mosfillime				
		Shfuqizimi	Gjykata			
			Prokurori me i larte			
		Përfundimi	Gjyqit			
			Pushuar			
			Pezulluar			
		Regjistruara	Gjithsej-procedime			
			Kundravajtje			
			Krimi	Me burgim deri 10 vjet		
				Me burgim mbi 10 vjet		
	Hetuara nga Prokurori					
	Urdhra delegimi					
	Urdhra ndalimi nga Prokurori					
	Gjithsej te pandehur					
	Masat e Sigurimit	Kërkesa e Prokurorit	Arrest Burg			
			Arrest Shtëpie			
			Garanci Pasurore			
			Detyrim Paraqitje			
		Vendimi i Gjykatës	Arrest Burg			
			Arrest Shtëpie			
	Kontrolle, kerk.Prok te vend. Gjykata					
	Përgjime, kerk.Prok te vend. Gjykata					
	Sig.Prove, kerk.Prok te vend, Gjykata					
	Pushuara	Mungese Fakti				
		Mungesë Provash				
		Shkaqe te tjera				
		Te pandehur				
		Te arrestuar				
		Cenime	Shfuqizuar nga Gjykata			
	Shfuqizuar nga Prokurori					
	Ripushuar					
	Dërguara ne gjyq					
	Pezulluar	Autori nuk dihet				
		1 pandehuri sëmure				
		Te pandehur				
		Te arrestuar				
		Rifilluar				
	Transferuara për kompetence					
	Zgjedhjet	Procedimi				
		Paraburgimi				
Dërguar Gjyqit	Gjithsej-procedime					
	Kundravajtje					
	Krimi	Me burgim deri 10 vjet				
		Me burgim mbi 10 vjet				
	Te pandehur					
	Te arrestuar					

Treguesit				Periudha			
				Vitet 2001	9-mujori 2002 I		
Ndjekja Penale në Hetimet Paraprake	Veprime Hetimore, Zgjidhjet e Rekomanduara dhe Përfundimi	Veprime Hetimore	Referime	Ngjarje			
				Kallëzime			
				Arrestime në flagrante			
			Hetuar	Ndalime			
				Procedime			
				Te pandehur			
		Zgjatje afati	Për procedimet në hetim	Te arrestuar			
				Për te paraburgosurit në hetim			
			Rekomandime Pushimi	Procedime	Gjithsej		
					Mungesë fakti		
				Te Pandehur	Mungesë provash		
					Shkaqe të tjera		
	Rekomandime Gjyqësive	Rekomandime Pezullimi	Gjithsej				
			Autori nuk dihet				
			1 pandehuri sëmurë				
		Rekomandime Gjyqësive	Mospranuar/ndryshuar				
			Procedime				
			Te pandehur				
	Cilësia	Te Pandehur	Te arrestuar	Mospranuar/ndryshuar			
				Te Lire	Pushuar/ndryshuar akuza		
				Revokuar/ndryshuar m. sigurimit			
			Pafajësi e plote				
			Pafajësi e pjesshme				
			Pafajësi e pjesshme				
Procedime		Shfuqizuar V. pushimit/pezullimit					
		Kthyer aktet nga gjykata					
		Pushuar ceshtja në gjykatë					
		Pafajësi					
Akte		Absolutisht të pavlefshme					
		Relativisht të pavlefshme					
	Urdhra/vendime për anulimin e tyre						
Urdhra Ekzekutimi të Zbatuara							

DREJTUESI I PROKURORISË

PROKURORI

